



## Përmirësimi i llogaridhënies politike në financimin e partive në Kosovë: Eksplorimi i varianteve për përmirësimin e mbikëqyrjes

### Përmbledhje ekzekutive

Financimi i partive politike në Republikën e Kosovës është i domosdoshëm në mënyrë që partitë politike të luajnë rolin që ju përket në politikëbërjen dhe proceset politike të Kosovës. Rrjedhimisht, mbajtja e strukturave organizative, zhvillimi i programeve, menaxhimi i degëve, zhvillimi i kampanjave zgjedhore në kohë zgjedhjesh, është arsye legjitime që partitë politike të kenë nevojë për mjete financiare.

Ka mënyra të shumta të financimit të partive politike në Kosovë, duke filluar nga anëtarësia në parti, subvencionet nga përfaqësimi në Parlamentin e Republikës së Kosovës por edhe nëpërmjet donacioneve nga sektori privat. Financimi përmes donacione nga kompanitë/ndërmarrjet private, në bazë të hulumtimit tonë (produkt i të cilit është libri *Rrjetet joformale të pushtetit, patronazhi politik dhe Klientelizmi në Serbi dhe Kosovë*) ka dal të jetë më problematiku, pasi këtu ndodh shumica e informalitetit ekonomik dhe politik, ku rrjetet informale krijohen dhe riafirmohen. Partitë politike kryesisht përdorin rrjetet formale që tashmë i kanë, për të siguruar financat e nevojshme nga kompanitë / ndërmarrjet private. Ato mblidhen kryesisht me kesh, dhe një pjesë relativisht e vogël merret edhe nëpërmjet sistemit bankar. Në vitet e fundit, sipas responentëve tanë, ky shërben si burimi kryesor i financimit të subjekteve politike në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes.

Zakonisht paratë në politikë operojnë pas dyerve të mbyllura dhe përfshijnë praktika nën hije. Shuma e saktë e parave/donacioneve dhe origjina e tyre, për subjektet politike, zakonisht nuk dihet. Kjo krijon një sistem të tillë ku grupe të caktuara të interesit kërkojnë favore apo kërkojnë influencë, qoftë në politikë apo edhe në prokurimin publik, si shkëmbim për përkrahjen e tyre.

Në Kosovë kemi mungesë të kontrollit dhe mbikëqyrjes së financimit të subjekteve politike që qon deri në mungesë të transparencës dhe klientelizëm. Si rezultat, duhet të ketë një vullnet politik për rritjen e transparencës, si mjet për reduktimin e patronazhit partiak dhe klientelizmit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në përfaqësim politik. Subjektet politike duhet t'i publikojnë raportet financiare në faqet zyrtare të tyre. Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjegjësisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet të përzgjedhë sa më shpejt auditorët në bazë të ligjit në fuqi. Pastaj duhet të krijohet mundësia që subjektet politike parlamentare që marrin fond nga buxheti i shtetit të auditohen nga auditori gjeneral, kurse për donacionet dhe kuotat e anëtarësisë, të auditohen nga auditorë privat të përzgjedhur me short. Qasja e shoqërisë civile dhe e mediave duhet të jetë më intensive sa i përket mënyrës së financimit të subjekteve politike dhe llogaridhënies.

## Çështjet e identifikuara

Njëri ndër mekanizmat e identifikuar gjatë hulumtimit tonë në kuadër të projektit “Praktikat informale të kapjes së burimeve ekonomike nga elitat politike: eksplorimi i patronazhit partiak në Kosovë dhe Serbi”, (produkt i të cilit është libri “Rrjetet joformale të pushtetit, patronazhi politik dhe Klientelizmi në Kosovë dhe Serbi”) për shkëmbimin e burimeve (votave, punësimit dhe parave) përmes praktikave informale, ka dalë të jetë financimi i partive politike.

Përpjekjet për të siguruar burime potenciale për financim të partive politike ose edhe të fushatave zgjedhore, dolën të jenë shtysa për zhvillimin e patronazhit dhe klientelizimit, ku biznese dhe individë të caktuar japin fonde kryesisht gjatë fushatave zgjedhore për subjektet e caktuara dhe si kundërshtpërblim marrin tenderë apo përpiqen të ndikojnë në politika të caktuara. Në këtë aspekt, janë identifikuar një numër i burimeve kryesore për të cilat subjektet politike ose individët kanë nevojë. Ato janë: paratë publike (fondi i demokratizimit), pagesa e anëtarësisë dhe financimi nga bizneset private.

## Korniza ligjore dhe praktikat

Ligji 03 / L- 174 Mbi Financimin e Subjekteve Politike e definon subjektin politik si person juridik jofitimprurës (Neni 3). Si i tillë ai mund të marrë burime financiare dhe materiale nga: kuota (pagesat) e anëtarësisë; kontributet; nga Buxheti i Republikës së Kosovës; nga çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me këtë ligj; nga të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik të përcaktuara me nenin 6 të këtij ligji (Neni 4). Subjekti politik nuk mund të ushtrojë veprimtari financiare fitimprurëse, përveç shitjes së të mirave siç janë: publikimet, botimet, shitja e materialeve reklamuese, posterëve me emblemën ose akronimin e subjektit politik dhe

burimeve të tjera të lejuara me ligj (Neni 6) (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010).

Në përputhje me ligjin e lartpërmendur, Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, Kuvendi i Kosovës ndan fond të veçantë për subjektet politike, që është Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për Demokratizim. Ky fond përfshin mbështetjen si për funksionim të përditshëm, aktivitete politike, por edhe për fushatë zgjedhore. Neni 7.4 i këtij ligji përcakton që: Burimet financiare publike, nga buxheti i Republikës së Kosovës, shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore, financimin dhe punën e Grupeve Parlamentare dhe financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010). Në anën tjetër e njëj edhe të drejtën e mbledhjes së donacioneve nga persona fizik dhe juridik. Është e përcaktuar qartë se sa mund të dhurojnë donacion personat fizik dhe kompanitë. Ligji përcakton që: 1.1. personat fizik, në vlerë prej, jo më shumë se dy mijë (2.000) Euro për një (1) vit kalendarik; 1.2. personat juridikë në vlerë prej - jo më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro për një (1) vit kalendarik (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010). Çfarëdo financimi që është në kundërshtim me ligjin, subjektet politike obligohen që t'i kthejnë mjetet tek financuesit në përputhje me ligjin. Në bazë të hulumtimit, jo gjithmonë ndodh kjo në praktikë. Një i intervistuar shpreh se “*Ka pas pare kesh që nuk kanë shku përmes bankave, ka pas edhe përtej shumave të lejueshme me ligj. Shuma çka paraqitet në media dhe KQZ, nuk është aspak e përafërt me atë se çka jepet në të zezën*” Anëtar partie. (SeConS, 2015).

Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për Demokratizim funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe sipas ligjit të parë, 0.17 të buxhetit vjetor. Shuma që i dedikohet këtij fondi, ndryshon në varësi të ndryshimit të buxhetit të përvjetshëm. Mënyra se si shpërndahet fondi për subjektet politike është përgjegjësi e KQZ-së. Këtë,

KQZ e bënë duke e shpërndarë tek grupet parlamentare në bazë të numrit të deputetëve.

Financimi i partive politike, sa i përket fushatës dhe aktiviteteve të tjera në Kosovë, bazuar në hulumtimin tonë, si fenomen, i ka dy aspekte: aspektin formal apo ligjor si dhe aspektin joformal. Ashtu siç u paraqit më lartë, financimi i partive përcaktohet me ligje dhe rregulla. Jo gjithmonë edhe zbatohen me përpikëri këto ligje dhe rregulla në praktikë, dhe jo gjithmonë financimi i fushatave dhe i subjekteve politike bëhet në përputhje me ligjin. Nga ana tjetër, shpeshherë subjekte të caktuara politike, sidomos ato që janë të ndërlidhura me institucionet, financohen pa i bërë publike ose transparente as burimet e financimit, por as qëllimet e shpenzimeve të tyre.

Sa i përket përkrahjes financiare nga bizneset private, shumë të intervistuar gjatë hulumtimit Praktikant informale të kapjes së burimeve ekonomike nga elitat politike: Eksplorim i patronazhit partiak në Kosovë dhe Serbi", kanë theksuar që disa parti përdorin rrjetet joformale për të siguruar financimin e nevojshëm. Një i intervistuar shpreh se: *"Zakonisht thonë që ky e ka financu këtë parti dhe ka marr pastaj privilegje. Por dëgjo: kur ta qes unë një kafe edhe ti ma qet. Ndodhin këto."* Anëtar partie (i intervistuari 2, 2015).

## Mungesa e raportimit financiar

Kur një subjekt politik regjistrohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pranon rregulla dhe detyrime të caktuara, e njëra nga këto është edhe raportimi financiar. Gjithashtu edhe raportimi financiar është i rregulluar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, siç janë Ligji për Financimin e Partive Politike, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe Rregulla Nr. 14/2015 Mbi Financimin e Subjekteve politike dhe Sanksionet.

Me Ligjin mbi Zgjedhjet dhe Ligjin mbi Financimin e Partive Politike, subjektet politike janë të obliguara t'i dërgojnë dy raporte në KQZ: raportin e shpenzimeve të fushatës parazgjedhore për çdo palë zgjedhje, disa ditë pas përfundimit të zgjedhjeve. Ndërsa për mënyrën e shpenzimit të Fondit të Demokratizimit, subjektet politike janë të obliguara të dorëzojnë në KQZ një raport vjetor të shpenzimeve që është raport i tërësishëm. Mirëpo subjektet politike janë po ashtu të obliguara të raportojnë çdo tre muaj, para çdo alokimi. Kjo përcaktohet edhe në Rregullën Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve politike dhe Sanksionet në Nenin 6.2 dhe 6.3. Po ashtu në bazë të kësaj Rregulle, në Nenin 9.3 Subjekti politik i cili pranon një kontribut, origjinën dhe prejardhjen e të cilit, kontributdhënësi nuk mund ta dëshmoj, detyrohet që brenda (2) jave, t'i njoftojë organet kompetente për vërtetimin e prejardhjes së këtij kontributi. (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2015). Ndërsa në Nenin 9.4, të po kësaj Rregulle, theksohet se, nëse nuk mund të dëshmohet prejardhja e kontributit, kjo vlerë mbetet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Raportet auditohen nga auditor të pavarur, të cilët deri në vitin 2012 i ka përzgjedh KQZ-ja me një tender të hapur. Nga viti 2013 auditorët nuk i përzgjedh më KQZ-ja por Kuvendi i Kosovës, gjë që në praktikë ende nuk ka ndodh. Raportet e zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2014 ende nuk janë audituar nga auditori, për faktin që në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës nuk ka arrit që ta përzgjedh kompaninë e auditimit, fillimisht, me arsyetimin e ngërçit politik.

Nëse hulumtohet në faqet zyrtare të partive politike, shumica prej tyre nuk e kanë publikuar Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës Zgjedhore. Në Nenin 7.2. f) të Rregullës Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve politike dhe Sanksionet, jepet qartë që partitë politike duhet ta

publikojnë Raportin Vjetor Financiar të vitit paraprak dhe Raportin Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake. Këto raporte, partitë politike duhet t'i mbajnë të publikuar për një vit në faqet zyrtare të tyre dhe t'i publikojnë në një rën nga gazetatat ditore kombëtare. Gjithashtu sipas Nenit 10 të kësaj Rregulle, këto dy raporte dorëzohen në KQZ dhe pastaj auditohen nga auditorë që i përzgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të Rregullës së lartpërmendur, në Nenin 10.7 duhet t'i publikoj të gjitha raportet vjetore financiare të partive politike dhe po ashtu së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike.

Mospublikimi i këtyre raporteve si nga ana e subjekteve politike, ka qar kështu në shkeljen e ligjeve dhe rregullës së lartpërmendur, e për të cilat shkelje nuk është ndërmarr asgjë. Gjithashtu edhe mos përzgjedhja e auditorit për auditimin e raporteve financiare të partive politike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qar në shkeljen e ligjit për Financimin e Subjekteve politike, gjegjësisht Nenit 19.1 dhe 19.2.

## Drejt mbikëqyrjes dhe llogaridhënies

### Gjendja aktuale

Në bazë të hulumtimit tonë, analizës ligjore dhe monitorimit të faqeve zyrtare të partive politike, shohim mos implementim të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) dhe Rregullës Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve politike dhe Sanksionet. Mos implementimi i kornizës ligjore dhe shkelja e neneve të caktuara ndodh edhe nga ana e institucioneve që e mbikëqyrin financimin e partive politike, që do të thotë nga KQZ-ja dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mënyra aktuale e përzgjedhjes së auditorëve për auditimin e shpenzimeve të subjekteve politike, vazhdon të mos e zgjedh problemin. Nëse deri në 2012 kishim së paku formalisht auditim dhe publikim të raporteve, për zgjedhjet e 2013 dhe 2014 nuk kemi fare as auditim dhe as publikim.

**Mbikëqyrja:** Si rezultat i mosfunksionimit të Kontrollit Financiar të paraparë me ligj dhe rregullore, nuk është duke u bërë mbikëqyrja e financave të partive politike, si financat vjetore edhe ato të fushatave zgjedhore.

**Transparenca:** Duke u shkelur nene të caktuara të ligjit dhe rregullës dhe duke mos funksionuar mbikëqyrja e financimit të partive politike, shihet qartë se ka probleme me llogaridhënie dhe transparencë. Nuk ka llogaridhënie nga subjektet politike ndaj KQZ-së dhe Kuvendit të Kosovës, po as nuk ka llogaridhënie dhe transparencë të të tria këto së bashku ndaj shoqërisë kosovare dhe taksapaguesve kosovar.

**Kostoja:** Mos implementimi i dispozitave ligjore në lidhje me raportimet financiare dhe sanksionet, mund të ketë kosto ekonomike dhe sociale/politike. Kosto ekonomike për arsye se mungesa e transparencës bën që klientelizmi dhe informaliteti të merr përmasa më të mëdha, duke dëmtuar kështu edhe ekonominë e vendit. Ndërsa, kosto shoqërore politike për arsye se dëmtton besimin e shoqërisë në sistemin politik dhe demokracinë.

### Alternativat e politikës

Sa i përket dispozitave ligjore në lidhje me financimin e subjekteve politike, fillimisht duhet të respektohen dhe të zbatohen në praktikë nga subjektet politike, KQZ-ja dhe nga Kuvendi i Kosovës. Në ndërkohë duhet shikuar sanksionet e parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjekteve politike nëse e kanë efektin e tyre, në mënyre që të shqyrtohet mundësia për rritjen e masave ndëshkuese.

# ANALIZË E SHKURTË

Duhet të theksohet që një faktor i rëndësishëm i mosauditimit dhe mungesës së mbikëqyrjes së mënyrës së financimit të subjekteve politike është mungesa e vullnetit politik. Kështu që një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet ta kenë politikanët e Kosovës, e veçanërisht deputetët e Kosovës.

Gjithashtu mënyra aktuale e auditimit të financimit të subjekteve politike duhet të pësojë disa ndryshime, në mënyrë që të kemi një auditim të integruar. Ku subjektet politike parlamentare për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit auditohen nga auditori gjeneral, ndërsa për pjesën e financimit nga kuotat e anëtarësisë dhe donacionet, auditohen nga auditorë privat të përzgjedhur me short. Ndërsa partitë politike joparlamentare, të cilat nuk financohen nga shteti, të auditohen vetëm nga auditorët privat të përzgjedhur me short po ashtu.

**Mbikëqyrja:** Funkcionon me zbatimin e ligjeve ne fuqi, përgjegjës për zbatimin e tyre është “trekëndëshi” Kuvendi i Kosovës – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – subjektet politike. Pastaj me dorëzimin e raporteve financiare dhe të fushatave zgjedhore të vitit 2013 dhe 2014 dhe auditimin e këtyre raporteve, do të ketë hapësirë për monitorimin e financave dhe identifikimin e shkeljeve eventuale në lidhje me financimin e subjekteve politike.

**Transparenca:** Në mënyrë që të rritet transparenca mbi financimin e subjekteve politike, secila parti politike duhet t’i publikoj raportet financiare. Qytetarët dhe akterë të ndryshëm duhet të kenë qasje të plotë në këto raporte. Gjithashtu, subjektet politike me LFSP janë të obliguara që të jenë transparente dhe ta luftojnë korrupsionin. Në nenin 17 të Ligjit për Financimin e subjekteve politike, ato “janë të detyruara të definojnë në statut mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të

tyre dhe, me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës, subjektet politike duhet të zhvillojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar”.

Kur bëhet fjalë për transparencën, duhet të gjendet rruga që raportet e partive politike të dorëzuara në KQZ dhe të publikohen, edhe pse nuk janë auditur ende. Nuk do të duhej që transparenca të cenohej si pasojë e dështimit të auditimit. Së paku publikimi do të krijonte një mundësi të mbikëqyrjes së financimit dhe shpenzimeve nga shoqëria e opinionit, e sidomos nga organizatat joqeveritare. Në ndërkohë, edhe institucionet e drejtësisë do të mund të shërbeheshin për qëllime hetimi apo ndjekje.

**Kostoja:** Fuqizimi i transparencës dhe llogaridhënies në lidhje me financimin e partive politike çon në reduktimin e klientelizmit dhe informalitetit me ç’rast edhe të kostos ekonomike, si dhe ruajtjen e besimit të qytetarëve në sistemin politik të vendit.

## Rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme qëllimisht jepen kryekëput në bazë hulumtimit tonë “Praktikat informale të kapjes së burimeve ekonomike nga elitat politike: Eksplorim i patronazhit partiak në Kosovë dhe Serbi”. Këto rekomandime jepen edhe në bazë të rishikimit të Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike dhe në bazë të Rregullës Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet. Rekomandimet e dhëna për ligjet dhe rregullën mbi FSP kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e dispozitave të caktuara, të cilat ndikojnë në luftimin e klientelizmit dhe informalitetit përmes rritjes së transparencës në financimin e partive politike. Kjo nuk e përjashton faktin që nuk ka nevojë për amendamente të

## ANALIZË E SHKURTË

neneve të caktuara në ligjet dhe rregullën e lartpërmendur. Ligji për Financimin e Subjekteve Politike duhet implementuar, gjegjësisht duhet të zbatohen nenet që kanë të bëjnë me raportimin financiar, kontrollin financiar dhe sanksionet.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet të përzgjedhë sa më shpejt auditorët në bazë të ligjit në fuqi për auditimin e Raporteve Vjetore Financiare për vitet 2013,2014 dhe 2015 dhe Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës për vitin 2013 dhe 2014 të subjekteve politike.

Të aplikohen dënimet për ato parti që nuk i kanë dorëzuar. Raportet Vjetore Financiare për vitet 2013,2014 dhe 2015, si dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës për vitin 2013 dhe 2014.

Duhet të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të mënyrës së auditimit si është bërë më parë dhe si është paraparë me ligjin e ri. Subjektet politike parlamentare për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit të auditohen nga auditori gjeneral, kurse për pjesën e financimit nga kuotat e anëtarësisë dhe donacionet, të auditohen nga auditorë privat të përzgjedhur me short. Ndërsa subjektet politike joparlamentare, që nuk financohen nga shteti, të auditohen nga auditorët privat të përzgjedhur me short po ashtu.

Në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia, subjektet politike duhet t'i publikojnë raportet financiare në faqet zyrtare të tyre.

Të krijohet një vullnet politik në luftimin e informalitetit dhe klientelizmit në raport me financimin e subjekteve politike.

Të rritet vetëdijesimi i brendshëm i subjekteve politike në raport me kontrollin e brendshëm

financiar dhe transparencën duke e futur në statutet e partive të tyre në mënyrë automatike paragrafin e parë të nenit 17 të Ligjit për Financimin e partive politike.

Të fuqizohet koordinimi në mes të subjekteve politike, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kuvendit të Kosovës në lidhje me raportimin financiar.

Mos raportimi i raporteve financiare dhe mos auditimi i tyre të bëhet çështje debati nëpër mediat kosovare dhe shoqërinë civile.

Krejt në fund, auditimi i raporteve paraqet një kontroll të jashtëm, edhe pse për dy palë zgjedhjet e fundit nuk është realizuar, duhet ta kemi të qartë se auditimi i raporteve deri në një farë mase do të reflektonte financimin e vërtetë dhe shpenzimet e vërteta të subjekteve politike që në nivele të ndryshme janë në pushtet. E vetmja mënyrë për të zbardhur skemën e financimit të subjekteve politike është hetimi real dhe i paanshëm i mënyrës se si shpërndahet paraja publike, nga tenderët, kontratat e mëdha të investimeve publike, subvencionet si dhe punësimet në sferën publike.

Gjithashtu duhet të konsiderohet një qasje e re dhe një mundësi e reformës se si financohen fushatat zgjedhore si tërësi, si dhe të eksplorohej mundësia e krijimit të një ndërmjetësi në mes të parasë private dhe subjekteve politike, siç janë Komitetet e Veprimt Politik (Political Action Committees PAC)

## Burimet:

Të dhënat primare nga hulumtimi mbi klientelizmin politik dhe patronazhin partiak, të realizuara nga Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim, brenda projektit “Rrjetet joformale të pushtetit, patronazhi politik dhe Klientelizmi në Kosovë dhe Serbi”.

SeCons, CRDP. (Maj 2016). Rrjetet joformale të pushtetit, patronazhi politik dhe Klientelizmi në Serbi dhe Kosovë. Beograd, Serbi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (31 korrik 2013). Ligji Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Prishtinë, Kosovë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (16 shtator 2010). Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Prishtinë, Kosovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. (16 janar 2015). Rregulla Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet. Prishtinë, Kosovë.

Titulli: Përmirësimi i llogaridhënies politike në financimin e partive në Kosovë: Eksplorimi i varianteve për përmirësimin e mbikëqyrjes

Autor: Yllka Buzhala

Edituar nga: Besa Kabashi - Ramaj

Përkthyer nga: Artan Sadiku

Botuar nga: Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**



**Regional Research  
Promotion Programme  
Western Balkans**



**UNIVERSITÉ DE FRIBOURG  
UNIVERSITÄT FREIBURG**

PPHR promovon hulumtimin shkencor social në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali të Zi dhe Serbi). Hulumtimi shkencor social ndihmon në të kuptuarit e nevojave specifike të reformave të vendeve të rajonit dhe në identifikimin e implikimeve afatgjata të zgjedhjeve politike. Hulumtuesit marrin mbështetje përmes granteve hulumtuese, trajnimeve metodologjike dhe tematike, dhe mundësi për krijimin e rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare si dhe mentorim. PPHR koordinohet dhe operohet nga Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe (IICEE) në Universitetin e Friburgut (Zvicër). Programi është i financuar plotësisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të Jashtme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë të shkurtë janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e SDC-së dhe Universitetit të Fribourgut.